| Djersë (Tretesire Acide dhe Bazike) | Ndryshimi Nota ≥ 4 | SSH EN ISO 105-E04:2013 ose ekuivalentin e tij. |
| **Ndryshimi dimensional** | | |
| Larje + Tharje | Pëlhura tëendura: Baza ± 5% , Indi ± 5% ;Pëlhura tëthurura: gjatësia + 2% deri -5%, gjërësia +5% deri -8% | SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij. |
| Qëndrueshmeria në tërheqje (vetëm për pëlhurat e endura) | Baza ≥ 400 N;<br>Indi ≥ 400 N; | SSH EN ISO 13934-1:2013 ose ekuivalentin e tij. |
| Efekti Piling (pushëzimi) 2000 cikle | ≥ 4 (pëlhurat e endura)<br>≥ 3 (pëlhurat e thurura) | SSH EN ISO 12947-2:2016 ose ekuivalentin e tij. |
| Sjellja ndaj zjarrit (ku specifikohet) | Nuk duhet të ndizet | SSH EN ISO 6941:2003 ose ekuivalentin e tij. |

*Shënim: Nëse çarçafi tek i poshtëm është me ngjyrë të bardhë atëherë nuk do të merret në konsideratë pjesa e karakteristikave që përcaktojnë qëndrueshmërinë e ngjyrës (në larje, në fërkim, në zbardhje dhe në djersë).*

*Veti shtesë*

- *Qëndrueshmeria ndaj avujve te ujit - Treguesit e vlerave nga prodhuesi.*
- *Vetitë e shëndetit dhe të sigurisë - Sipas normave europiane dhe/ ose kombëtare.*
- *Prodhimi + aksesorët - Konstruksioni, aksesorët dhe prodhimi duhet të jenë të përshtatshëm për produktin dhe përdorimin e destinuar.*
- *Filli i ngjyrosur - Të ketë qëndrueshmëri të ngjyrës si produkti bazë (për produktet me ngjyrë).*

*Me pretendimin si vijon: [...] "*

*Lidhur me kete artikull, ne dyshojme qe keta operatore te kene paraqitur: Dokumentacion plotesues per Vetite Shtese: Qendrueshmeria ndaj avujve te ujit. Treguesit e vlerave nga prodhuesi. Vetite e shendetit dhe te sigurise. Sipas normave europiane dhe/ ose kombetare. Prodhimi + aksesoret. Konstruksioni, aksesoret dhe prodhimi duhet te jene te pershtatshem per produktin dhe perdorimin e destinuar. Filli i ngiyrosur. Te kete qendrueshmeri te ngjyres si produkti baze (per produktet me ngjyre); te kerkuara ne DST, nga prodhuesit e lendes se pare te materialit me te cilen prodhohet me pas carcafi i poshtem i shtratit. Ne dyshojme gjithashtu, qe materiali i perdorur per te prodhuar mostrat e paraqitura nga keta OE te kete peshen e kerkuar. Nje carcaf i poshtem duhet te peshoje nga 430 gr deri 480 gr, ndersa pesha e mostres se dorezuar nga secili prej ketyre OE eshte me e vogel se pesha e kerkuara per nje carcaf te perfunduar. Ne dyshojme gjithashtu, se permasat e carcafit te paraqitur si master nga secili prej ketyre OE te jene ne perrnasat e kerkuara 90 cm x 200 cm x 15 cm. Ne dyshojme gjithashtu, qe mostra e paraqitur nga secili prej ketyre OE, te kene te qepur ne trup etiketen qe tregon te dhenat mbi perberjen e materialit, instruksionet e larjes, etj. Mos plotesimi i kesaj kerkese duhet ti kishte sherbyer KVO si argument per te refuzuar ofertat e ketyre OE."*

*Komisioni i Shqyrtimitte Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vleresimin e bere ne sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi "AN&RA" SHPK, pretendimet e parashtruara ne ankese mbi kualifikimin e ofertes se tij nga ofertuesi "Malbertex" konstatoi se:*

*Per ofertuesin "AN&RA" SHPK, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka njoftuar automatikisht nepermjet sistemit te prokurimit elektronik me date 09.09.2020, kualifikimin te ofertes se tij,*

*Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga Ofertuesi "AN&RA" SHPK dhe konstatoi:*

*Ne dokumentat e tenderit ne shtojcen nr. 9 ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" ne seksionin 2.3 "Kapaciteti teknik" pika 5 percaktohet se, operatori ekonornik pjesemarres, duhet te paraqes mostrat/kampionet e disa prej artikujve qe kerkohen te prokurohen, si dhe deshmi per rezultatet e testimeve zyrtare ne lidhje me lenden e pare te tyre (raporte testimi/ flete analiza), te leshuara nga laboratore te akredituar, e konkretisht per artikujt si vijon:*

*a) Kellef i dyshekut tek ortopedik (artikulli nr.1 ne tabelen e shtojces*

*b) Carcafi tek i poshtem (artikulli nr. 5 ne tabelen e shtojces*

*) Kellef i jastekut (artikulli nr. 6 ne tabelen e shtojces d) Peshqir per duar (artikulli nr. 7 ne tabelen e shtojces*

*Secili prej artikujve te sipercituar, duhet te dorezohet ne 1 (nje) kampion/moster. Mostrat/ kampionet e kerkuara me siper, duhet te kene nje etikete te qepur, e cila te permbaje: "emri i artikullit", "daten e zhvillimit te tenderit", "emrin e prodhuesit/ofertuesit", "nenshkrimin dhe vulen e operatorit ekonomik". Mostrat do te paraqiten ne daten dhe oren e hapjes se ofertave prane Ministrise se Brendshme, Agjencia e Blerjeve te Perqendruara me adrese: Sheshi "Skenderbej", nr.3, Tirane.*

*Ne specifikimet teknike ne shtojcen nr. 10 ne lidhje me artikullin 'cercaf tek i poshtem", nder te tjera percaktohet edhe veti shtese si vijon:*

*Veti shtese*

*Oendrueshmeria ndaj avujve te ujit- Treguesit e vlerave nga prodhuesi.*

*Vetite e shendetit dhe te sigurise- Sipas normave europiane dhe/ ose kombetare.*

*Prodhimi + aksesoret - Konstruksioni, aksesoret dhe prodhimi duhet tejene te pershtatshem per produktin dhe perdorimin e destinuar.*

*Filli i ngivrosur- Te kete qendrueshmeri te ngjyres si produkti haze (per produktet me ngjyre).*

*Se pari, nga verifikimi i dokumenteve te tenderit rezulton se lidhur me mostrat I kampionet e disa prej artikujve qe kerkohen te prokurohen eshte kerkuar te paraqitet raport testimi ose flete analize e leshuar nga laboratore te akredituar. Nga verifikimi ne sistemin elekronik te prokurimit rezulton se operatori ekonomik "AN&RA" SHPK ka dorezuar raporte testimi per te gjithe mostrat e kerkuara, te cilat konsistojne ne analiza te vetive dhe tregueseve kryesor cilesor te lendes se pare te mostrave. Lidhur me vetite shtese, per sa kohe qe nuk eshte kerkuar asnje dokumentacion provues ne kriteret e percaktuara ne shtojcen nr. 9 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit", percaktimet e bera ne specifikimet teknike lidhur me artikujt objekt prokurimi, mund te verifikohen ne cdo kohe nga autoriteti kontraktor perfitues gjate zbatimit te kontrates ne zbatim te legjislacionit ne fuqi. Gjithashtu, operatori ekonomik ka dorezuar deklarate mbi permbushjen e specifikimeve teknike, ku ka deklaruar se permbush te gjitha specifikimet teknike, te percaktuara ne dokumentat e tenderit.*

*Se dyti: Nga procesverbali i dorezimit te mostrave date 27.08.2020, mbajtur per mostrat e dorezuara prane organit qendror bleres Agjencia e Blerjeve te Perqendruara, nga verifikimi fizik i permasave, rezultoi se keto permasa jane konform specifikimeve teknike te kerkuara ne DST, ndersa ne lidhje me pretendimimin e ofertuesit se "nje carcaf i poshtem duhet te peshoje nga 430 gr deri 480 gr" sqarojme se nuk ka nje kerkese te tille ne dokumentat e tenderit.*

*Ne lidhje me pretendimin e ofertuesit ankimues se "dyshojme gjithashtu, qe mostra e paraqitur nga secili prej ketyre OE, te kene te qepur ne trup etiketen qe tregon te dhenat mbi perberjen e materialit, instruksionet e larjes, etj.," sqarojme se ne dokumentat e tenderit nuk ka nje kerkese te tile te percaktuar, por eshte kerkuar qe secili prej artikujve te sipercituar, duhet te dorezohet ne 1 (nje) kampion/ moster. Mostrat/ kampionet e kerkuara me siper, duhet te kene nje etikete te qepur, e cila te permbaje: "emri i artikullit", "daten e zhvillimit te tenderit", "emrin e prodhuesit/ofertuesit", "nenshkrimin dhe vulen e operatorit ekonomik". Etiketat jane kerkuar per produktet qe nuk jane pjese e mostrave te kerkuara.*

*Per arsyet e mesiperme pretendimi i ofertuesit "Malbertex" SHPK nuk pranohet.*

*3.Ofertuesi "Malbertex" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertuesit "AN&RA" SHPK per mospermbushjen e kritereve ne shtojcen nr. 10 "Specifikimet teknike" per artikullin "Kellef jasteku" ne dokumentat e tenderit ku percaktohet:*

***Përbërje:*** *100% pambuk.*

***Ngjyra:*** *Sipas kërkesave të AK.*

***Përmasat:****80 x 50 cm.*

***Masa:****160-180 gr/m².*

| ***Karakteristika të këllëfit të jastëkut*** | | |
|---|---|---|
| ***Vetite*** | ***Kërkesa*** | ***Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij.*** |
| ***Qëndrueshmëria e ngjyrës*** | | |
| *Larje 40℃* | *Ndryshimi Nota ≥ 4* | *SSH EN ISO 105-C10:2007ose ekuivalentin e tij.* |
| *Fërkim* | *Në të thatë ≥ 3-4*<br>*Nëtënjomë ≥ 3* | *SSH EN ISO 105-X12:2016 ose ekuivalentin e tij.* |
| *Zbardhje (peroksid)* | *Ndryshimi Nota ≥ 4* | *SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij.* |
| *Djersë (Tretesire Acide dhe Bazike)* | *Ndryshimi Nota ≥ 4* | *SSH EN ISO 105-E04:2013 ose ekuivalentin e tij.* |
| ***Ndryshimi dimensional*** | | |
| *Larje + Tharje* | *Pëlhura të endura: Baza ± 5% , Indi ± 5% ;*<br>*Pëlhura të thurura: gjatësia + 2% deri -5%, gjërësia +5% deri -8%* | *SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij.* |
| *Qëndrueshmeria në tërheqje (vetëm për pëlhurat e endura)* | *Baza ≥ 400 N;*<br>*Indi ≥ 400 N;* | *SSH EN ISO 13934-1:2013ose ekuivalentin e tij.* |
| *Efekti Piling (pushëzimi) 2000 cikle* | *≥ 4 (pëlhurat e endura)*<br>*≥ 3 (pëlhurat e thurura)* | *SSH EN ISO 12947-2:2016 ose ekuivalentin e tij.* |
| *Sjellja ndaj zjarrit (ku specifikohet)* | *Nuk duhet të ndizet* | *SSH EN ISO 6941:2003 ose ekuivalentin e tij.* |

*Shënim: Nëse këllëfi i jastëkutështë me ngjyrë të bardhë atëherë nuk do të merret në konsideratë pjesa e karakteristikave që përcaktojnë qëndrueshmërinë e ngjyrës (në larje, në fërkim, në zbardhje dhe në djersë).*

***Veti shtesë***

- *Qëndrueshmeria ndaj avujve te ujit - Treguesit e vlerave nga prodhuesi.*
- *Vetitë e shëndetit dhe të sigurisë - Sipas normave europiane dhe/ ose kombëtare.*
- *Prodhimi + aksesorët - Konstruksioni, aksesorët dhe prodhimi duhet të jenë të përshtatshëm për produktin dhe përdorimin e destinuar.*
- *Filli i ngjyrosur - Të ketë qëndrueshmëri të ngjyrës si produkti bazë (për produktet me ngjyrë).*

*Me pretendimin si vijon: [...] "Lidhur me kete artikull, ne dyshojme qe keta operatore te kene paraqitur: Dokumentacion plotesues per Vetite Shtese: Qendrueshmeria ndaj avujve te ujit. Treguesit e vlerave nga prodhuesi; Vetite e shendetit dhe te sigurise. Sipas normave europiane dhe/ ose kombetare; Filli i ngiyrosur. Te kete qendrueshmeri te ngjyres si produkti baze (per produktet me ngjyre); te kerkuara ne DST, nga prodhuesit e lendes se pare te materialit me te cilen prodhohet me pas carcafi i poshtem i shtratit. Ne dyshojme gjithashtu, se permasat e mostres se kellefit te jastekut te paraqitur nga secili prej ketyre OE te jene ne permasat e kerkuara 80cm x 50 cm. Ne dyshojme gjithashtu, qe mostra e paraqitur nga secili prej ketyre OE te kete te qepur ne trup etiketen qe tregon te dhenat mbi perberjen e materialit, instruksionet e larjes, etj. Mos plotesimi i kesaj kerkese duhet ti kishte sherbyer KVO si argument per te refuzuar ofertat e ketyre OE.*

*Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vleresimin e bere ne sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi "AN&RA" SHPK, pretendimet e parashtruara ne ankese mbi kualifikimin e ofertes se tij nga ofertuesi "Malbertex" konstatoi se:*

*Per ofertuesin "AN&RA" SHPK, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka njoftuar automatikisht nepermjet sistemit te prokurimit elektronik me date 09.09.2020, kualifikimin te ofertes se tij.*

*Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga Ofertuesi "AN&RA" SHPK dhe konstatoi:*

*Ne dokumentat e tenderit ne shtojcen nr. 9 ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" ne seksionin 2.3 "Kapaciteti teknik" pika 5 percaktohet se, operatori ekonomik pjesemarres, duhet te paraqes mostrat/kampionet e disa prej artikujve qe kerkohen te prokurohen, si dhe deshmi per rezultatet e testimeve zyrtare ne lidhje me lenden e pare te tyre (raporte testimi/ flete analiza), te leshuara nga laboratore te akredituar, e konkretisht per artikujt si vijon:*

*a) Kellef i dyshekut tek ortopedik (artikulli nr. 1 ne tabelen e shtojces*

*b) Carcafi tek i poshtem (artikulli nr. 5 ne tabelen e shtojces*

*c) Kellef i jastekut (artikulli nr. 6 ne tabelen e shtojces*

*d) Peshqir per duar (artikulli n.r. 7 ne tabelen e shtojces*

*Secili prej artikujve te sipercituar, duhet te dorezohet ne 1 (nje) kampion/ moster, Mostrat/ kampionet e kerkuara me siper, duhet te kene nje etikete te qepur, e cila te perrnbaje: "emri i artikullit", "daten e zhvillimit te tenderit", "emrin e prodhuesit/ofertuesit", "nenshkrimin dhe vulen e operatorit ekonomik". Mostrat do te paraqiten ne daten dhe oren e hapjes se ofertave prane Ministrise se Brendshme, Agjencia e Blerjeve te Perqendruara me adrese: Sheshi "Skenderbej", nr.3, Tirane.*

*Ne specifikimet teknike ne shtojcen nr. 10 ne lidhje me artikullin "kellef jasteku", nder te tjera percaktohet edhe veti shtese si vijon:*

*Veti shtese*

*Qendrueshmeria ndaj avujve te ujit- Treguesit e vlerave nga prodhuesi.*

*Vetite e shendetit dhe te sigurise- Sipas normave europiane dhe/ ose kombetare.*

*Prodhimi + aksesoret - Konstruksioni, aksesoret dhe prodhimi duhet te jene te pershtatshem per produktin dhe perdorimin e destinuar.*

*Filli i ngjyrosur- Te kete qendrueshmeri te ngjyres si produkti baze (per produktet me ngjyre).*

*Se pari, nga verifikimi i dokumenteve te tenderit rezulton se lidhur me mostrat/kampionet e disa prej artikujve qe kerkohen te prokurohen eshte kerkuar te paraqitet raport testimi ose flete analize e leshuar nga laboratore te akredituar. Nga verifikimi ne sistemin elekronik te prokurimit rezulton se operatori ekonomik "AN&RA" SHPK ka dorezuar raporte testimi per te gjithe mostrat e kerkuara, te cilat konsistojne ne analiza te vetive dhe treguesve kryesor cilesor te lendes se pare te mostrave.*

*Lidhur me vetite shtese, per sa kohe qe nuk eshte kerkuar asnje dokumentacion provues ne kriteret e percaktuara ne shtojcen nr. 9 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit", percaktimet e bera ne specifikimei teknike lidhur me artikujt objekt prokurimi, mund te verifikohen ne cdo kohe nga autoriteti kontraktor perfitues gjate zbatimit te kontrates ne zbatim te legjislacionit ne fuqi. Gjithashtu, operatori ekonomik ka dorezuar deklarate mbi permbushjen e specifikimeve teknike, ku ka deklaruar se permbush te gjitha specifikimet teknike, te percaktuara ne dokunentat e tenderit.*

*Se dyti: Nga procesverbali i dorezimit te mostrave date 27.08.2020, mbajtur per mostrat e dorezuara prane organit qendror bleres Agjencia e Blerjeve te Perqendruara, nga verifikimi fizik i permasave, rezultoi se keto permasa jane konform specifikimeve teknike te kerkuara ne DST.*

*Ne lidhje me pretendimin e ofertuesi ankimues se "qe mostra e paraqitur nga secili prej ketyre OE te kete te qepur ne trup etiketen se tregon te dhenat mbi perberjen e materialit, instruksionet e larjes, " sqarojme se ne dokumentat e tenderit nuk ka nje kerkese te tille te percaktuar, por eshte kerkuar qe secili prej artikujve te sipercituar, duhet te dorezohet ne 1 (nje) kampion/moster.*

*Mostrat/ kampionet e kerkuara me siper, duhet te kene nje etikete te qepur, e cila te permbaje: "emri i artikullit", "daten e zhvillimit te tenderit", "emrin e prodhuesit/ofertuesit", "nenshkrimin dhe vulen e operatorit ekonomik". Etiketat jane kerkuar per produktet qe nuk jane pjese e mostrave te kerkuara.*

*Per arsyet e me siperme pretendimi i ofertuesit "Malbertex" SHPK nuk pranohet.*

*4.Ofertuesi "Malbertex" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertuesit "AN&RA" SHPK per mospermbushjen e kritereve ne shtojcen nr. 10 "Specifikimet teknike" per artikullin "Peshqir duaresh" ne dokumentat e tenderit ku percaktohet:*

***Përbërja:** 100% pambuk.*

***Ngjyra:** Me ngjyra të ndryshme sipas kërkesave të AK-së.*

***Përmasa:** 90x 50 cm dhe me thurje me vjega.*

***Masa:**350- 400g/m$^2$.*

| ***Karakteristika të Peshqirit*** | | |
|---|---|---|
| ***Vetitë*** | ***Kërkesa*** | ***Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij.*** |
| ***Qëndrueshmëria e ngjyrës*** | | |

| | | |
|---|---|---|
| *Larje 40 ℃* | *Ndryshimi Nota ≥ 4* | *SSH EN ISO 105-C10:2007ose ekuivalentin e tij.* |
| *Fërkim* | *Në të thatë ≥ 3-4*<br>*Në të njomë ≥ 3* | *SSH EN ISO 105-X12:2016 ose ekuivalentin e tij.* |
| *Stabiliteti dimensional* | *Pëlhura të endura: Baza ± 5% , Indi ± 5% ;Pëlhura të thurura: gjatësia + 2% deri - 5%, gjërësia +5% deri -8%* | *SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij.* |
| *Qëndrueshmëria në tërheqje (vetëm për pëlhurat e endura)* | *Baza ≥ 300 N;*<br>*Indi ≥ 300 N;* | *SSH EN ISO 13934-1:2013ose ekuivalentin e tij.* |

*Shënim: Nëse peshqirët e duarve janë me ngjyrë të bardhëatëherënuk do të merret në konsideratë pjesa e karakteristikave që përcaktojnë qëndrueshmërinë e ngjyrës (në larje,fërkim).*

***Veti shtesë***

*Aftesia per tu njomur - Treguesit e vlerave nga prodhuesi.*

- *Vetitë e shëndetit dhe të sigurisë - Sipas normave europiane dhe/ ose kombëtare.*
- *Prodhimi + aksesorët - Konstruksioni, aksesorët dhe prodhimi duhet të jenë të përshtatshëm për produktin dhe përdorimin e destinuar.*
- *Ndryshimi dimensional - Informacioni për hyrjen e pritur të peshqirit duhet të sigurohet nga prodhuesi.*

*Me pretendimin si vijon: [...] "Lidhur me kete artikull, ne dyshojme qe keta operatore te kene paraqitur: Dokumentacion plotesues per Vetite Shtese: Aftesia per tu njomur - Treguesit e vlerave nga prodhuesi; Vetite e shendetit dhe te sigurise. Sipas normave europiane dhe/ ose kombetare; Ndryshimi dimensional. Informacioni per hyrjen e pritur te peshqirit duhet te sigurohet nga prodhuesi; te kerkuara ne DST, nga prodhuesit e lendes se pare te materialit me te cilen prodhohet me pas peshqiri i duarve. Ne dyshojme gjithashtu, qe materiali i perdorur per te prodhuar mostrat e paraqitura nga keta OE te kete peshen e kerkuar. Nje peshqir me formatin 90 cm x 50 cm dhe me peshen e kerkuar nga 350 gr/m2 deri 400 gr/m2, duhet te peshoje nga 157 gr deri 180 gr, pesha e tyre eshte me e vogel se e kerkuara per nje peshqir te perfunduar. Ne dyshojme gjithashtu, se permasat e mostres se peshqirit, te paraqitur nga secili prej ketyre OE, te jete ne permasat e kerkuara 90 cm x 50 cm. Ne dyshojme gjithashtu, qe mostra e paraqitur nga secili prej ketyre OE te kete te qepur ne trup etiketen qe tregon te dhenat mbi perberjen e materialit, instruksionet e larjes, etj. Mos plotesimi i kesaj kerkese duhet ti kishte sherbyer KVO si argument per te refuzuar ofertat e ketyre OE."*

*Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vleresimin e bere ne sistemin e prokurirnit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi "AN&RA" SHPK, pretendimet e parashtruara ne ankese mbi kualifikimin e ofertes se tij nga ofertuesi "Malbertex" konstatoi se:*

*Per ofertuesin "AN&RA" SHPK, Komisioni i Vleresimit te Ofertavc ka njoftuar automatikisht nepermjet sistemit te prokurimit elektronik me date 09.09.2020, kualifikimin te ofertes se tij.*

*Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga Ofertuesi "AN&RA" SHPK dhe konstatoi:*

*Ne dokumentat e tenderit ne shtojcen nr. 9 ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" ne seksionin 2.3 "Kapaciteti teknik" pika 5 percaktohet se, operatori ekonomik pjesemarres, duhet te*

*paraqes mostrat/ kampionet e disa prej artikujve qe kerkohen te prokurohen, si dhe deshmi per rezultatet e testimeve zyrtare në lidhje me lëndën e parë të tyre (raporte testimi/ fletë analiza), të lëshuara nga laboratorë të akredituar, e konkretisht për artikujt si vijon:*

1. *Këllëf i dyshekut tek ortopedik (artikulli nr. 1 në tabelën e shtojcës*
2. *Çarçafi tek i poshtëm (artikulli nr. 5 në tabelën e shtojcës*
3. *Këllëf i jastëkut (artikulli nr. 6 në tabelën e shtojcës*
4. *Peshqir për duar (artikulli nr. 7 në tabelën e shtojcës*

*Secili prej artikujve të sipërcituar, duhet të dorëzohet në 1 (një) kampion/ mostër. Mostrat/ kampionet e kërkuara më sipër, duhet të kenë një etiketë të qepur, e cila të përmbajë: "emri i artikullit", "datën e zhvillimit të tenderit", "emrin e prodhuesit/ofertuesit", "nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik". Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave pranë Ministrisë së Brendshme, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara me adrese: Sheshi "Skënderbej", nr.3, Tiranë.*

*Ne specifikimet teknike ne shtojcen nr. 10 ne lidhje me artikullin "peshqir duar", nder te tjera percaktohen edhe veti shtese si vijon:*

*Veti shtese*

- *<u>Aftesia per tu njomur</u> - Treguesit e vlerave nga prodhuesi.*
- *<u>Vetitë e shëndetit dhe të sigurisë</u> - Sipas normave europiane dhe/ ose kombëtare.*
- *<u>Prodhimi + aksesorët</u> - Konstruksioni, aksesorët dhe prodhimi duhet të jenë të përshtatshëm për produktin dhe përdorimin e destinuar.*
- *<u>Ndryshimi dimensional</u> - Informacioni për hyrjen e pritur të peshqirit duhet të sigurohet nga prodhuesi.*

*Se pari, nga verifikimi i dokumenteve te tenderit rezulton se lidhur me mostrat/kampionet e disa prej artikujve qe kerkohen te prokurohen eshte kerkuar te paraqitet raport testimi ose flete analize e leshuar nga laboratore te akredituar. Nga verifikimi ne sistemin elekronik te prokurimit rezulton se operatori ekonomik "AN&RA" SHPK ka dorezuar raporte testimi per te gjithe mostrat e kerkuara, te cilat konsistojne ne analiza te vetive dhe tregueseve kryesor cilesor te lendes se pare te mostrave. Lidhur me vetite shtese, per sa kohe qe nuk eshte kerkuar asnje dokumentacion provues ne kriteret e percaktuara ne shtojcen nr. 9 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit", percaktimet e bera ne specifikimet teknike lidhur me artikujt objekt prokurimi, mund te verifikohen ne cdo kohe nga autoriteti kontraktor perfitues gjate zbatimit te kontrates ne zbatim te legjislacionit ne fuqi. Gjithashtu, operatori ekonomik ka dorezuar deklarate mbi permbushjen e specifikimeve teknike, ku ka deklaruar se permbush te gjitha specifikimet teknike, te percaktuara ne dokumentat e tenderit.*
*Se dyti: Nga procesverbali i dorezimit te mostrave date 27.08.2020, mbajtur per mostrat e dorezuara prane organit qendror bleres Agjencia e Blerjeve te Perqendruara, nga verifikimi fizik i permasave, rezultoi se keto permasa jane konform specifikimeve teknike te kerkuara ne DST, ndersa ne lidhje me pretendimimin e ofertuesit se "duhet te peshoje nga 157 gr deri 180 gr, pesha e tyre eshte me e vogel se e kerkuara per nje peshqir te perfunduar" sqarojme se nuk ka nje kerkese te tille ne dokumentat e tenderit.*

*Ne lidhje me pretendimin e ofertuesi ankimues se "qe mostra e paraqitur nga secili prej ketyre OE te kete te qepur ne trup etiketen qe tregon te dhenat mbi perberjen e materialit,*

*instruksionet e larjes,", sqarojme se ne dokumentat e tenderit nuk ka nje kerkese te tille te percaktuar, por eshte kerkuar qe secili prej artikujve te duhet te dorezohet ne 1 (nje) kampion/moster. Mostrat/ kampionet e kerkuara me siper, duhet te kene nje etikete te qepur, e cila te permbaje: "emri i artikullit", "daten e zhvillimit te tenderit", "emrin e prodhuesit/ofertuesit", "nenshkrimin dhe vulen e operatorit ekonomik". Etiketat jane kerkuar per produktet qe nuk jane pjese e mostrave te kerkuara.*
*Per arsyet e mesiperme pretendimi i ofertuesit "Malbertex"SHPK nuk pranohet.*
*Ofertuesi "Malbertex" SHPK pretendimet e parashtuara me lart i ka ngrituar dhe per ofetuesit "Atlantik" SHPK, "Gentian Sadiku" PF, "Univers promotions" SHP dhe "Eraldi" SHPK. Gjithashtu ofertuesi ka pretenduar ne ankese si vijon:*
*"Ne ndihme te KSHA ju bejme me dije se "MALBERTEX" shpk ploteson kerkesat e specifikimeve teknike per Vetite shtese te produkteve te kerkuara. Per te permbushur kete kerkese te DST kemi dorezuar: a-Deklarat nga prodhuesi i lendes se pare per vetite e mbrojtjes se shendetit. Prodhuesi i lendes se pare eshte i paisur me certifikate OEKO-tex, sipas deklarates se tij. b-Rezultatet per qendrueshmerine ndaj avujve te ujit. -per kellefin e jastekut rreshti 17, flete analizes se prodhuesit te lendes se pare, per kellefin e dyshekut rreshti 16, flete analiza e prodhuesit te lendes se pare. –Per carcafin e poshtem rreshti 17, flete analiza e prodhesit te lendes se pare. c- Ndryshimi dimensional per peshqirin, rreshti 16, flete analiza e prodhesit, d- Treguesit per dizifektante per pastrimin e siperfaqes se kellefit te dyshekut, nga prodhuesi i lendes se pare: Per agjentet pastrues te kellefit te dyshekut, treguesit ne rreshti 18 te flete analizes se prodhuesit."*

III.1.3. Nisur nga pretendimet e ankimuesit si dhe referuar informacionit e dokumenatcionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor konstatohet se, operatorët ekonomikë "“An&Ra” sh.p.k, “Atlantik” sh.p.k, “Gentian Sadiku” p.f, “Univers Promotios” sh.p.k dhe “Eraldi” sh.p.k kanë paraqitur mostrat dhe fletë analizat për produktet e kërkuara, objekt ankese.

III.1.4. Sa më sipër cituar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në ankesën drejtuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë K.P.P, operatori ekonomik ankimues “Malbertex” sh.p.k nuk parashtron fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori* për të gjithë mostrat në total, duke ngritur dyshime e hamendësime, nëse i plotëson kriteret e vendosura në DST nga shoqëritë “An&Ra” sh.p.k, “Atlantik” sh.p.k, “Gentian Sadiku” p.f, “Univers Promotios” sh.p.k dhe “Eraldi” sh.p.k, të kualifikuar nga ana e autoritetit kontraktor.

III.1.5. Akoma më tej, referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimimit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshëm të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 20, “Forma dhe përmbajtja e ankesës”,* pika 3:

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;”*

III.1.6. Bazuar në sa mësipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicje dhe argumenta ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë.

Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 52 të LPP dhe nenit 64 e 65 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e Autoritetit Kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.1.7. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljet e pretenduara, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku i bazon pretendimet e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve ekonomikë të tjerë.

Theksojmë se mospërmbushja e kritereve apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë, në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikisht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe, pretendimit/pretendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.1.9. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimuesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe, në kuptim të misionit të tij për të siguruar eficencën e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qendrim *pro-aktiv*, në krah të operatorit ankimues. Në rastin e dytë, kur operatori pjesmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plotë provues se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimuesit.

III.1.10. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicje të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.1.11. KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i

Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Rrjedhimisht pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues "Malbertex" sh.p.k. nuk merren shqyrtim.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues se: "*Per OE Atlantik shpk, Gentian Sadiku p.f, Univers Promotions shpk, Eraldi shpk, ne dyshojme dhe e kemi sigurine se keta OE nuk plotesojne piken:*
*2.3 Kapaciteti teknik:*
*1) Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per furnizimet e meparshme te ngjashme, te kryera gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e zhvillimit te procedures, ne vleren prej te pakten 40 % te vleres se fondit te marreveshjes kuader te ketij Loti. Keto furnizime te ngjashme duhet te vertetohen me dokumentacionin si me poshte:*
*a) Autoriteti kontraktor si deshmi per pervojen e meparshme kerkon vertetime te leshuara nga nje ent publik ose fatura tatimore te shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara,*
*Kur furnizimet e ngjashme jane realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet te paraqese faturen perkatese tatimore te shitjes ku te shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.*
*Te gjithe keta OE nuk kane kontrata te ngjashme sikurse kerkohet ne DST; ata mund te kene kontrata furnizimi me artikuj te ngjashem ne emertim, por qe nuk plotesojne kerkesen e shprehur ne DST dhe jane te ndryshme si per nga qellimi i perdorimit, ashtu edhe menyra e realizimit te tyre*", Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se;

III.2.1. Parashikimi i nenit 63, pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, kërkohet shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Sa më sipër KPP gjykon se është e nevojshme të ndalet në elementët e testit të legjitimimit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elementë janë *interesi* i ankuesit, *dëmi real ose potencial i pritshëm* dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor *i marrë në kundërshtim me ligjin.*

III.2.2. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

III.2.3. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që, përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Për sa kohë që pretendimet e ankimuesit për operatorin ekonomik "An&Ra" sh.p.k, e cila ka paraqitur ofertën më të ulët ekonomike, nuk qëndrojnë pasi Komisioni i Prokurimit Publik ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të datës 09.09.2020 dhe gjendja faktike juridike e operatorit ekonomik "An&Ra", sh.p.k mbetet e

kualifikuar, pretendimet e tjera të palës ankimuese për s'kualifikimin e ofertave të operatorëve të tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi nuk merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrative, pasi cilido qoftë fati i pretendimeve të tij, pala ankimuese nuk mund të arrijë dot qëllimin e saj final të fitimit të kontratës.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "*Për miratimin e rregullave* "*Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19"*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Malbertex" sh.p.k, për procedurën e prokurimit me Nr. REF-43442-11-14-2019, me objekt: "*Blerje Uniforma për personelin e shërbimit të urgjencës mjekësorë",* me fond limit 57.900,605 lekë pa tvsh, zhvilluar me date 10.12.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
**Nr. 1206 Protokolli**
**Datë 30.09.2020**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

| Anëtar | Anëtar | Anëtar |
|---|---|---|
| **Vilma Zhupaj** | **Lindita Skeja** | **Merita Zeqaj** |

**Kryetar**
**Jonaid Myzyri**

Jonaid Myzyri
Digitally signed by Jonaid Myzyri
Date: 2020.12.01 10:26:05 +02'00'